



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute

DREJTËSIA NË ZGJEDHJET 2017

**RAPORT RRETH PËRGJIGJES SË ORGANEVE TË DREJTËSISË NDAJ KRYERSVE TË
VEPRAVE PENALE KUNDËR TË DREJTAVE TË VOTIMIT**

Prishtinë, gusht 2017

Autorë: Betim Musliu dhe Ehat Miftaraj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

RRETH PROJEKTIT

Instituti i Kosovës për Drejtësi, po zbaton projektin “Iniciativa për ngritje të efikasitetit të organeve të drejtësisë për proces zgjedhor të lirë, drejtë dhe demokratik”, i cili ka për qëllim që të forcojë kapacitetet dhe rrisë bashkëpunimin me organet e drejtësisë në luftimin e efektiv të çfarëdo lloji krimi që pengon procesin e lirë, të drejtë dhe të besueshëm zgjedhor në Kosovë. Ky projekt mbështetet nga Ambasada Amerikane në Prishtinë.

IKD ka traditë në zbatimin e projekteve të kësaj natyre, duke mbështetur organet e ndjekjes në trajnim dhe ofrim të këshillave rreth ndjekjes efikase të krimeve të zgjedhjeve, sensibilizimin e opinionit rreth krimeve të zgjedhjeve, mbikëqyrjen e përgjigjes së organeve të drejtësisë sa i përket krimeve të zgjedhjeve, si dhe përpilimin e raporteve të cilat japin rekomandime konkrete për të përmirësuar funksionimin e organeve të drejtësisë në të ardhmen.

Qëndrimet e shprehura në raport janë të autorëve, ato nuk janë domosdoshmërisht qëndrime të donatorit.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Hyrja 1, Kati 1, Nr. 1

Rr. Rustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Gusht 2017

Prishtinë, Republika e Kosovës

përkrahur nga:



Përmbajtja:

1. Përmbledhje ekzekutive.....	4
2. Hyrje	6
3. Metodologjia.....	8
4. Korniza ligjore për veprat penale kundër të drejtave të votimit	9
5. Hetimet, ndjekja penale dhe shpallja e aktgjykimeve	10
a. Roli proaktiv i institucioneve të sigurisë dhe ndjekjes	10
b. Rastet e iniciuara dhe hetimet penale rreth zgjedhjeve	15
c. Ngritja e aktakuzave dhe shpallja e aktgjykimeve	17
6. Rekomandimet.....	20

1. Përmbledhje ekzekutive

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) në bashkëpunim me Iniciativa për Progres (INPO) dhe Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) kanë monitoruar aktivitetet e institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë për mbrojtjen e votës në zgjedhjet e parakohshme nacionale, të mbajtura më 11 qershor 2017.

Në fokus të monitorimit kanë qenë reagimet e organeve të drejtësisë dhe sigurisë ndaj ankesave të qytetarëve dhe zyrtarëve kompetent për organizimin e zgjedhjeve, rreth dyshimeve për kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit. Monitorimi është kryer nga 65 monitorues mobil dhe ka përfshirë ditën e monitorimit të zgjedhjeve të parakohshme nacionale të mbajtura më 11 qershor 2017 në tërë territorin e Republikës së Kosovës, përfshi komunat e veriut të Mitrovicës.

IKD vlerëson qasjen, standardin dhe angazhimin e organeve të sigurisë dhe ndjekjes në lidhje me reagimin ndaj veprimtarive penale kundër të drejtave të votimit. Në të gjitha këto aspekte, PSh dhe Policia e Kosovës (PK) kanë shënuar progres, gjithnjë duke krahasuar hetimin dhe ndjekjen e krimeve në zgjedhjet e viteve paraprake, sidomos zgjedhjet nacionale të vitit 2010.

Bashkëpunimi ndër-institucional është thelluar me nënshkrimin e një memorandumit bashkëpunimi në mes të KGJK-së, KPK-së, PK-së, KQZ-së dhe PZAP-së. Ky bashkëpunim ka dhënë rezultate konkrete gjatë gjithë procesit të zgjedhjeve. Arritja më e madhe, sikurse në të kaluarën, vlerësohet krijimi i Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) në mes të PSh-së dhe PK-së. PSV-të kanë qenë trungu i bashkëpunimit efikas të paparë deri më tani sa i përket hetimit dhe ndjekjes së krimeve kundër të drejtës së zgjedhjeve në Kosovë.

Gatishmëria e Prokurorit të Shtetit ka qenë në nivelin e duhur, duke angazhuar për 24 orë 100 prokurorë kujdestar në ditën e votimit, të cilët në bashkëpunim me policinë iu kanë përgjigjur rasteve të incidenteve që ndërlidhen me sigurinë e procesit të zgjedhjeve.

Një nga shqetësimet e mëdha në këto zgjedhje është shënuar me aktivitetin e pazbardhur të një OJQ-je, e cila ishte e panjohur në publik dhe për të cilën janë ngritur dyshime për veprimtarinë e saj. KQZ kishte akredituar rreth 30 mijë vëzhgues në monitorimin e ditës së votimit më 11 qershor 2017. Pak ditë para zgjedhjeve, organizata “Instituti Rajonal për Demokraci të Drejtat e Njeriut dhe Studime Politike” kishte paraqitur kërkesë në KQZ për akreditimin e 4548 vëzhguesve për ditën e votimit më 11 qershor. Informacionet rreth kësaj OJQ-je ishin të mangëta dhe anëtarët e KQZ-së, kanë ngritur dyshimet e tyre në lidhje me qëllimin e kësaj organizate, e cila është vlerësuar si organizatë fantome. Ndaj këtij akreditimi të numrit të vëzhguesve të kësaj organizate janë ngritur dyshime të shumta dhe debat publik. Prokurori i Shtetit ka heshtur në lidhje me veprimtarinë e kësaj OJQ-je. Kundër kësaj të fundit, partia Vetëvendosje ka parashtruar një kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Prishtinë. Nuk ka përgjigje se çfarë është ndërmarrë në lidhje me parashtrimin e këtij kallëzimi penal.

Në ditën e votimit janë shënuar disa incidente të vogla, shkelje të rregullave të procesit të zgjedhjeve dhe disa tentime për të kryer vepra penale që ndërlidhen me të drejtën e votimit.

Vetëm për ditën e votimit janë ngritur kallëzime penale ndaj 16 personave, për veprat penale “Kanosje e kandidatit”, “Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve”, “Keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve”, “Dhënia ose marrja e ryshfetit lidhur me votimin”, “Keqpërdorimi i të drejtës të votimit”, “Falsifikimi i rezultateve të votimit”, “Asgjësimi i dokumenteve të votimit”, “Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar”, “Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë” dhe “Lajmërimi apo kallëzimi i rremë”. Të gjitha kallëzimet penale ndaj këtyre personave janë ushtruar në PTh-të të Prishtinës, Prizren, Pejë, Ferizaj dhe Gjilan.

Përderisa, KQZ ende nuk ka dërguar asnjë rast tek Prokurori i Shtetit, PZAP bazuar në rastet e pranuar dhe shqyrtuara, ka dërguar 14 dosje në Prokurori të Shtetit, për të cilat ka konsideruar se mund të ketë elemente të veprave penale për t’i hetuar më tutje.

Përderisa, sistemi prokurorial dhe sistemi gjyqësor, ende janë duke u sfiduar me lëndët e vjetra të zgjedhjeve paraprake, të cilat nuk kanë përfunduar, për zgjedhjet e 11 qershorit 2017, nga kallëzimet penale që janë ngritur ndaj 16 personave, prokurorët kanë ngritur aktakuza ndaj 7 personave. Prej tyre ndaj tre personave janë shpallur aktgjykime dënuese, si rezultat i pranimit të fajësisë nga të akuzuarit, ndërsa rastet tjera janë në proces.

Politika e ndjekjes dhe dënimeve, vazhdon të mbetet sfidë për sistemin e drejtësisë, i cili ende nuk ju ka dhënë përgjigje adekuate manipuluesve të zgjedhjeve, duke i ndjekur organizatorët dhe duke i shqiptuar dënime adekuate, për të arritur qëllimin e dënimit.

Sidoqoftë, përjashtojë lëshimet eventuale të cilat janë evidentuar në ditën e votimit më 11 qershor 2017, përgjithësisht rezultatet pozitive të treguara në koordinimin ndërmjet institucioneve të drejtësisë kanë ndikuar drejtpërdrejtë në mbarëvajtjen e përgjithshme të zgjedhjeve, të cilat janë vlerësuar si nga vendorët ashtu dhe nga ndërkombëtarët si zgjedhje të organizuara mirë, fer dhe demokratike.

Organet e drejtësisë mbetet që përkushtimin e formalizuar në letër përmes memorandumit, ta dëshmojnë në praktikë, duke i trajtuar me prioritet lëndët e zgjedhjeve. Veprat penale që ndërlidhen me zgjedhjet janë mjaftë të ndërlidhura dhe se format e ndryshme që ekzistojnë në Kosovë krijojnë hapësirë për manipulime që paraqesin sfidë të madhe për organet e drejtësisë.

IKD sikurse në të kaluarën vlerëson se ndërlidhja e punësimit në administratën publike dhe përkrahja për partinë e caktuar politike është vetëm një nga krimet të cilat është vështirë të zbulohet, por që organet e ndjekjes duhet të shfrytëzojnë të gjitha mundësitë ligjore për zbardhjen e këtij klientelizmi. Gjithsesi në këtë drejtim, fokusi i organeve të ndjekjes duhet të jetë tek hetimi i financimit të aktiviteteve të partive politike.

2. Hyrje

Sundimi i ligjit vazhdon të mbetet fusha më e brishtë e qeverisjes në Republikën e Kosovës. Sfidat në ndërtimin e rendit dhe ligjit në Kosovë prej përfundimit të luftës kanë qenë të shumta, duke krijuar një sistem të drejtësisë, i cili vazhdimisht ka qenë i ekspozuar ndaj ndërhyrjeve të pushtetit.

Ndikimet politike kanë vazhduar edhe pas shpalljes së pavarësisë, ku proceset për zgjedhjen e bartësve të institucioneve më të rëndësishme të sistemit të drejtësisë janë ndikuar praktikisht nga politika. Kjo ka ndikuar drejtpërdrejtë në funksionimin e brishtë të sistemit të drejtësisë, i cili nuk ka arritur të garantoj respektimin e sundimit të ligjit në Kosovë. Në këtë drejtim, mungesa e efikasitetit për ndjekje dhe gjykim të veprave penale të cilat kanë rrezikshmëri të lartë për shoqërinë ka qenë sfidë e madhe për sistemin e drejtësisë.

Ndër veprat penale më serioze janë edhe ato të cilat ndërlidhen me të drejtën e votimit. Në të kaluarën, manipulimi enorm i zgjedhjeve ka krijuar pasoja të shumta, të cilat nuk janë kufizuar vetëm në humbjen e besimit në organet e drejtësisë, por edhe në humbjen e besimit të qytetarëve në procesin e zgjedhjeve, legjitimitetin e brishtë të Kuvendit, dëmtimin e institucioneve dhe buxhetit, dhe dëmtimin e imazhit të vendit. Republika e Kosovës ka pasur probleme të theksuara dhe të vazhdueshme me organizimin dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve si lokale ashtu edhe nacionale, pjesërisht edhe për shkak të përgjigjes jo adekuate të organeve të drejtësisë. Në këtë drejtim, duhet theksuar zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010, të cilat u karakterizuan me manipulim industrial të votave. Për këto manipulime, prokurorët kishin ngritur akuza të drejtpërdrejta duke i trajtuar këto krime si krime individuale, duke dështuar në ndjekjen e organizatorëve të këtyre krimeve.¹ Gjithashtu, dënimet e gjykatësve për këto raste kanë qenë mjaftë të buta krahasuar me dëmet e shkaktuara dhe problematikën.²

Megjithatë, akuzat penale dhe dënimet gjyqësore për komisionerët e vitit 2010 kanë shërbyer për edukim të të gjithë publikut rreth pasojave ligjore sa i përket përfshirjes në kryerjen e veprave penale të zgjedhjeve. Ish-Kryeprokurori i Shtetit, qysh në zgjedhjet lokale të vitit 2013 kishte ndërmarrë hapat në përputhje me mësimet e nxjerra nga e kaluara, duke nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi rreth zgjedhjeve mes KPK, KGJK, PK, KQZ dhe PZAP. Tutje, IKD kishte propozuar dhe hartuar Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) mes Prokurorit të

¹ Për rastet e vitit 2010 prokurorët kanë ngritur akuza për 232 raste ndaj 1,456 personave dhe se në proces të ngritjes së aktakuzave janë edhe 758 komisionerë të tjerë. QNR kishte nxjerrë nga auditimi i 890 vendvotime se në 712 vendvotime kishin pasur shumë gabime të cilat tejkalonin marzhën e gabimeve të thjeshta. Në gjithë këto vendvotime gabimet janë bërë nga 5,000 komisionerë, të cilët në vende të ndryshme, në kohë të njëjtë kanë vepruar njëjtë. Dështimi për të hetuar krimin e organizuar në zgjedhje ndërlidhet ngushtë edhe me dështimin e prokurorëve për të hetuar financimin e dyshimtë të partive politike, dështimin e materialeve zgjedhore dhe të listat e pasakta të votuesve. Të gjitha këto krime kanë kaluar pa u ndëshkuar. Gashi A. dhe Musliu B. "Krimi i organizuar në zgjedhje: Analizë e politikës së ndjekjes dhe dënimeve". Instituti i Kosovës për Drejtësi. Qershor 2012. (Shih linkun <http://kli-ks.org/wp-content/uploads/2015/05/Krimi-i-Organizuar-ne-Zgjedhje-KLI.pdf>)

² Për rastet e vitit 2010, gjykatat kanë zgjidhur 97 lëndë ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 135 tjera. Dënimet e shqiptuara nga gjykatësit janë 30 raste dënim me burgim, 35 raste me gjobë, 9 me kusht, 1 dënim tjetër, 5 raste aktgjykim lirues, 4 raste aktgjykim refuzues, dhe 3 raste janë zgjidhur në mënyrë tjetër. Gashi A. dhe Musliu B. "Krimi i organizuar në zgjedhje: Analizë e politikës së ndjekjes dhe dënimeve". Instituti i Kosovës për Drejtësi. Qershor 2012. (Shih linkun <http://kli-ks.org/wp-content/uploads/2015/05/Krimi-i-Organizuar-ne-Zgjedhje-KLI.pdf>)

Shtetit dhe Policisë së Kosovës, të cilat sollën sukses në ndjekjen e manipuluesve të zgjedhjeve, duke ndërtuar rol proaktiv të këtyre institucioneve. Kjo praktikë është ndjekur edhe në zgjedhjet nacionale të vitit 2014, në zgjedhjet lokale për Kryetar të Drenasit në vitin 2016 si dhe tash së fundi në zgjedhjet e parakohshme nacionale të 11 qershorit 2017. Memorandumi i Bashkëpunimit në mes të institucioneve të sundimit të ligjit ka ndikuar në ngritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit në mes të këtyre institucioneve në ndërmarrjen e aktiviteteve për luftim të suksesshëm të veprave penale kundër të drejtave të votimit duke përfshirë këtu, edhe parandalimin e këtyre veprave penale që bien ndesh me legjislacionin në fuqi.

Për dallim nga e kaluara, për zgjedhjet e 11 qershorit 2017³, janë shënuar një numër minimal i incidenteve, ku janë përfshirë 16 persona në manipulimin e zgjedhjeve, ndaj të cilëve janë ngritur kallëzime penale në Prokuroritë Themelore. Gjithashtu, në afat rekord janë ngritur aktakuza për disa prej këtyre rasteve, në të cilat janë shpallur aktgjykimet menjëherë për shkak të pranimit të fajësisë nga të akuzuarit.

Tashmë është ndërtuar një praktikë e mirë, e cila aktivizon me kohë organet e drejtësisë për të pasur rol proaktiv në organizimin e zgjedhjeve në aspektin e sigurisë, parandalimin dhe luftimin e veprave penale kundër të drejtës së votimit. Në këtë drejtim rol të rëndësishëm ka luajtur edhe marrëdhënia e veçantë me publikun, duke e sensibilizuar përmes aktiviteteve të ndryshme gjatë fushatës zgjedhore.⁴ Gatishmëria e Policisë dhe Prokurorit të Shtetit përmes angazhimit të një numri të madh të policëve dhe 100 prokurorëve kujdestar, ka ndikuar që bashkëpunimi i qytetarëve në ditën e votimit të jetë në nivel të duhur, duke raportuar rastet tek organet e ndjekjes.

³ Për zgjedhjet e parakohshme nacionale të 11 qershorit 2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka certifikuar 26 subjekte politike për pjesëmarrje në zgjedhje. Prej tyre, janë certifikuar pesë koalicione, 19 parti politike dhe dy nisma qytetare, ndërsa janë evidentuar 971 kandidatë për deputetë. Në këto zgjedhje morën pjesë 29.264 vëzhgues. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

⁴ Përveç hartimit dhe miratimit të PSV-ve, të cilat e mundësojnë një qasje dhe standard tepër profesional të organeve të ndjekjes, Koordinatorja Nacionale ka organizuar trajnime për prokurorët, është angazhuar në sensibilizimin e opinionit duke bashkë-organizuar me IKD-në shtatë debate në qendrat kryesore të vendit së bashku me përfaqësuesit e Prokurorive Themelore në qendrat përkatëse si dhe përfaqësuesit e policisë, gjyqësorit, KQZ-së, PZAP-it, partive politike, shoqërisë civile dhe mediave. Shoqëria civile ka kontribuar në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve dhe sidomos komisionerëve të partive politike sa i përket ndryshimeve në Kodin Penal si dhe angazhimin e institucioneve shtetërore për të hetuar dhe ndjekur rastet e manipulimit të zgjedhjeve.

3. Metodologjia

Bazuar në praktikat e ndërtuara në zgjedhjet lokale 2013⁵, zgjedhjet nacionale 2014 dhe zgjedhjet për komunën e Drenasit të vitit 2016, IKD ka vazhduar monitorimin të monitoroj përgjigjet e organeve të drejtësisë ndaj ankesave të qytetarëve dhe zyrtarëve të caktuar rreth dyshimeve për vepra penale kundër të drejtave të votimit.

IKD më datë 7 qershor 2017, ka organizuar tryezën “Drejtësia në zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2017” ku kanë marr pjesë të gjithë akterët kryesore, në të cilën tryezë është diskutuar për përgatitjen dhe gatishmërinë e institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë në sigurimin e mbarëvajtjes së procesit të zgjedhjeve.

Në ditën e zgjedhjeve të parakohshme nacionale të mbajtura më 11 qershor 2017, IKD ka bërë monitorimin e zgjedhjeve në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Monitorimi është realizuar nga IKD në bashkëpunim me Iniciativa për Progres (INPO) dhe Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) me përkrahje të Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Tri organizatat për ditën e votimit kanë angazhuar 65 monitorues, përfshi monitoruesit mobil në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, monitorues statik në disa prej qendrave të votimit që janë konsideruar më problematike si dhe monitoruesit e vendosur në Qendrën e Monitorimit në IKD në zyrat e saj Prishtinë. Monitoruesit mobil para orës 7 të mëngjesit kanë qenë të vendosur në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës dhe gjatë gjithë ditës së monitorimit janë shpërndarë nëpër vendvotime të ndryshme për të monitoruar aktivitetet dhe përgjigjet e organeve të drejtësisë në rastet e incidenteve eventuale që ndërlidhen me veprat penale kundër të drejtës së votimit. Të gjitha informacionet e siguruar nga burime të ndryshme dhe drejtpërdrejtë në vendvotime nga monitoruesit janë dërguar në Qendrën e Monitorimit në IKD, ku më pas këto informacione janë konfirmuar, duke komunikuar edhe me organet e Policisë dhe Prokurorisë, për tu përcjell përfundimisht tek publiku dhe mediat. IKD, INPO dhe GLPS gjatë ditës së votimit ka mbajtur tre konferenca për shtyp, për të informuar publikun lidhur me mbarëvajtjen e zgjedhjeve dhe reagimin e institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë në rastet kur janë raportuar dyshimet për keqpërdorim të drejtës së votimit. Përmes këtij lloji të monitorimit të veçantë të aktiviteteve dhe përgjigjes së organeve të drejtësisë në lidhje me veprat penale kundër të drejtës së votimit, IKD ka ndikuar në presion publik për të siguruar hetim dhe ndjekje efikase, përfshirë këtu thellimin e bashkëpunimit ndër-institucional, ngritjen e standardit të hetimeve, si dhe thellimin e bashkëpunimit në mes të organeve të drejtësisë dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës përmes sensibilizimit të publikut dhe shtrirjes së dorës për bashkëpunim të mirëfilltë.

⁵ Memorandum Bashkëpunimi në mes të Prokurorit të Shtetit dhe Institutit të Kosovës për Drejtësi, Prokurori i Shtetit, 23 shtator 2013.

4. Korniza ligjore për veprat penale kundër të drejtave të votimit

Për të mundësuar një luftë sa më efikase dhe efektive në ndjekje dhe gjykim të manipulimeve në zgjedhje, legjislacioni në Republikën e Kosovës në Kodin Penal të Republikës së Kosovës i ka kushtuar një kapitull të veçantë këtyre veprave. Derisa, Kapitulli XVI “Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut” i Kodit të vjetër Penal i Kosovës përmbante gjashtë vepra penale që ndërlidheshin me zgjedhjet,⁶ Kodi i ri Penal tanimë përmban 11 vepra penale.⁷ Kuvendi i Kosovës përmes ndryshimeve ligjore i ka kushtuar një rëndësi të veçantë të drejtave të votimit. Në Kodin e ri Penal tashmë ka një ashpërsim të dënimeve për veprat penale kundër të drejtave të votimit, duke i kategorizuar ato si krime të rënda.

Veprat e reja sanksionojnë veprimet inkriminuese në tri faza përgjatë procesit të zgjedhjeve, duke përfshirë vepra penale që mund të kryhen para ditës së votimit, gjatë ditës së votimit dhe pas ditës së votimit.⁸ Zgjedhjet nacionale të vitit 2010 janë evidentuar si zgjedhjet më të këqija të organizuara pas përfundimit të luftës në Kosovë. Karakteristikë e këtyre zgjedhjeve ishin përfshirja në manipulime kryesisht e komisionerëve të zgjedhjeve. Kodi i ri Penal ka ashpërsuar dukshëm dënimet ndaj kësaj kategorie, ku në secilin rast kur secila prej veprave penale mund të kryhet nga komisionerët e zgjedhjeve dënimet janë tejet të ashpra.⁹

IKD vlerëson se 11 veprat penale që sanksionojnë veprimet kriminale që ndërlidhen me zgjedhjet në Kodin Penal përkufizojnë mjaftueshëm të gjitha veprimet dhe mënyrat e kryerjes së këtyre veprave penale rreth procesit të zgjedhjeve dhe të drejtave të votimit në Kosovë.

⁶Shënim: Kodi i vjetër Penal i Republikës së Kosovës ishte baza e legjislacionit penal për sanksionimin e veprimeve kriminale në zgjedhje, i cili u kishte kushtuar një rëndësi të veçantë këtyre veprave, të cilat përcaktoheshin në nenet 176, 177, 178, 179, 180 dhe 181. Këto nene sanksionojnë veprimet kriminale ndaj të gjithë personave të cilët në çfarëdo mënyre pengojnë votuesit që të ushtrorjnë të drejtën e votës, ndërmarrin çfarëdo veprimtarish korruptive, përdorin dhunë në ditën e votimit, votojnë disa herë të njëjtit votues, zbulojnë votën e fshehtë, mashtrojnë në votime dhe asgjësojnë në forma të ndryshme dokumentet e votimit. Dënimet e parapara në këto dispozita ligjore parashohin dënime me gjobë, kusht dhe burgim efektiv deri në pesë (5) vjet. *Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kapitulli XVI: Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut*, Kuvendi i Republikës së Kosovës, prill 2003.

⁷ Avancimi i legjislacionit penal në këtë drejtim përkufizon veprimet kriminale kundër të drejtave të votimit që ndërlidhen me: cenimin e së drejtës për të kandiduar, kanosjen e kandidatit, parandalimin e ushtrimit të së drejtës për të votuar, cenimin e përcaktimit të lirë të votuesve, keqpërdorimin e detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve, dhënien ose marrjen e ryshfetit në lidhje me votimin, keqpërdorimin e të drejtës së votimit, pengimin e procesit të votimit, cenimin e fshehtësisë së votimit, falsifikimin e rezultateve të votimit, asgjësimin e dokumenteve të votimit.

⁸ Shënim: Veprat penale nga kapitulli XVIII, “Veprat penale kundër të drejtave të votimit” mund të kryhen përgjatë gjithë procesit të zgjedhjeve, duke përfshirë veprimet kriminale para, gjatë dhe pas ditës së votimit. Disa nga veprat penale që mund të kryhen në përgatitje të zgjedhjeve sanksionohen në nenet 210 “*Cenimi i së drejtës për të kandiduar*” dhe 211 “*Kanosja e kandidatit*”. Disa nga veprat penale që mund të kryhen në përgatitje dhe në ditën e zgjedhjeve sanksionohen në nenet 212 “*Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar*”, neni 214 “*Keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve*” dhe neni 215 “*Dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin*”. Disa nga veprat penale që mund të kryhen në ditën e zgjedhjeve sanksionohen në nenet 213 “*Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve*”, 216 “*Keqpërdorimi i të drejtës së votimit*”, neni 217 “*Pengimi i procesit të votimit*” dhe neni 218 “*Cenimi i fshehtësisë së votimit*”. Disa nga veprat penale që mund të kryhen në ditën e zgjedhjeve pas mbylljes së procesit të votimit sanksionohen në nenet 219 “*Falsifikimi i rezultateve të votimit*” dhe 220 “*Asgjësimi i dokumenteve të votimit*”.

⁹ Shënim: Kodi i ri përcakton vepra penale, të cilat përqendrohen te komisionerët e zgjedhjeve, ndaj të cilëve në secilin rast dënimet ashpërsohen si në vijim: Nëse veprat penale nga neni 212 dhe 218 kryhen nga komisionerët e zgjedhjeve dënimet janë minimum prej 1 deri në 5 vite burgim. Nëse vepra penale nga neni 214 kryhet nga komisionerët e zgjedhjeve dënimi është minimum prej 2 deri në 5 vite burgim. Nëse veprat penale nga nenet 215, 216, 219 dhe 220 kryhen nga komisionerët e zgjedhjeve atëherë dënimi minimal për ta është prej 3 deri në 5 vite burgim.

5. Hetimet, ndjekja penale dhe shpallja e aktgjykimeve

IKD si organizata e parë që ka ndërtuar një praktikë të monitorimit të institucioneve të drejtësisë në trajtimin e rasteve që ndërlidhen me veprat penale kundër të drejtave të votimit, vlerëson qasjen dhe standardin e PSh-së në trajtimin me prioritet të këtyre rasteve. Ky standard për herë të parë në bashkëpunim me IKD-në dhe institucionet tjera u ndërtua në zgjedhjet lokale të vitit 2013, u avancua në zgjedhjet nacionale 2014, ndërsa ka vazhduar njëjtë edhe në zgjedhjet nacionale të 11 qershorit 2017. Tashmë në Kosovë, zgjedhjet janë të lira, demokratike dhe fer, të cilat njihen nga partitë politike dhe faktori ndërkombëtarë, pavarësisht incidenteve të vogla që janë shënuar, por për të cilat ka pasur një reagim adekuat të institucioneve të drejtësisë, në këtë rast duhet theksuar policinë dhe prokurorinë. Si asnjëherë më parë, në lidhje me rastet e incidenteve të evidentuara në zgjedhjet nacionale të 11 qershorit 2017 menjëherë janë ngritur aktakuza ndaj kryesve të dyshuar për kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit. Koha e ngritjes së aktakuzave në këto raste, nëse krahasohet me rrethanat e Kosovës dhe praktikatat e rasteve tjera të sistemit të drejtësisë, mund të vlerësohet si kohë e arsyeshme dhe rekorde.

a. Roli proaktiv i institucioneve të sigurisë dhe ndjekjes

a) Bashkëpunimi ndër-institucional

Mësimet nga dështimet e institucioneve të drejtësisë në zgjedhjet e organizuara pas përfundimit të luftës, sidomos zgjedhjet nacionale të vitit 2010, kanë shërbyer që institucionet e drejtësisë të mobilizohen mirë për të reaguar në çdo incident, i cili e cenon mbarëvajtjen e procesit të zgjedhjeve. Fillimisht, bashkëpunimi tashmë tradicional në mes të institucioneve të drejtësisë është formalizuar përmes nënshkrimit të një Memorandumi të Bashkëpunimit në mes të Prokurorit të Shtetit, Policisë së Kosovës, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Panelit për Zgjedhjen e Ankesave dhe Parashtresave.

Derisa në të kaluarën, roli i organeve të ndjekjes kishte qenë shumë pasiv dhe veprimet ishin ndërmarr vetëm pasi ishin krijuar pasojat, tashmë ekziston një qasje më proaktive e bazuar në parandalim dhe në ndjekje proaktive të veprave penale kundër të drejtave të votimit. Bashkëpunimi ndër-institucional buron nga legjislacioni pozitiv në Kosovë, por vazhdimisht është fuqizuar përmes memorandumeve të bashkëpunimit.¹⁰ Ky bashkëpunim ka dhënë rezultate konkrete gjatë gjithë procesit të zgjedhjeve 2013. Për herë të parë, Kryeprokurori i Shtetit kishte caktuar Koordinatorin Nacionale për Zgjedhje, e cila kishte ndërmarrë hapa për të siguruar zbatimin e Memorandumi të Bashkëpunimit si dhe koordinimin e të gjithë akterëve. Arritja më e madhe si rezultat i Memorandumi të Bashkëpunimit ishte krijimi i PSV në mes të PSh-së dhe PK-së, të cilat kishin saktësuar veprimet për hetim dhe ndjekje efikase të veprave që ndërlidhen

¹⁰ *Shënim:* Ishte Kryeprokurori i Shtetit, Ismet Kabashi, i cili kishte ftuar organet sikurse Policinë e Kosovës, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, dhe Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, për të përpiluar dhe nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi për zgjedhjet 2013. *Memorandum Bashkëpunimi në mes KPK, KGJK, PK, KQZ, dhe PZAP lidhur me zgjedhjet 2013*, 18 shtator 2013. Kjo praktikë ishte vazhduar edhe për zgjedhjet e tjera të organizuara në Kosovë si për zgjedhjet lokale ashtu edhe nacionale.

me zgjedhjet, gjithnjë duke u bazuar në mësimet e nxjerra nga e kaluara dhe përvojat më të mira bazuar në ligjet në fuqi. PSV-të ishin rekomandim i drejtpërdrejtë nga IKD, e cila kishte hartuar PSV-të, të cilat më pas PSh përmes një grupi punues i kishte finalizuar dhe kishte vendosur së bashku me PK-në t'i zbatojnë për të shtuar efikasitetin dhe efektivitetin në ndjekjen e veprave penale kundër të drejtës së votimit. Sikurse në raportet preliminare, IKD vlerëson se PSV-të kanë qenë trangu i bashkëpunimit efikas të paparë deri më tani sa i përket hetimit dhe ndjekjes së krimeve të caktuara në Kosovë.

Gatishmëria e Prokurorit të Shtetit ka qenë në nivelin e duhur, duke angazhuar për 24 orë 100¹¹ prokurorë kujdestar në ditën e votimit, të cilët në bashkëpunim me policinë iu kanë përgjigjur rasteve të incidenteve që ndërlihen me sigurinë e procesit të zgjedhjeve.

Përjashtojmë leshimet eventuale, përgjithësisht rezultatet pozitive të treguara në koordinimin ndërmjet institucioneve të drejtësisë kanë ndikuar drejtpërdrejtë në mbarëvajtjen e përgjithshme të zgjedhjeve, të cilat janë vlerësuar si nga vendorët ashtu dhe nga ndërkombëtarët si zgjedhje të organizuara mirë, fer dhe demokratike. Përveç incidenteve për të cilat ka pasur më pas kallëzime penale dhe aktakuza, vëzhguesit e Misionit të Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (EU EOM) kanë theksuar se “megjithatë, zgjedhjet u ndikuan negativisht nga dobësitë e vjetra, veçanërisht nga listat e pasakta të votuesve që janë të cenueshme ndaj mashtrimeve, një sistem zgjedhor që lë mundësi për abuzim, dhe një sistem me shumë të meta për votim jashtë Kosovës.” Sipas tyre, “në zonat me shumicë serbe, procesi zgjedhor u dëmtua nga frikësimi dhe rastet e dhunës brenda komunitetit serb të Kosovës kundër kandidatëve dhe votuesve. Po ashtu pati një reagim të pamjaftueshëm nga prokuroria dhe policia ndaj atyre incidenteve”.¹²

b) Dështimet e organeve të ndjekjes për të hetuar veprimtarinë e dyshimtë të OJQ-së monitoruese e zgjedhjeve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kishte akredituar rreth 30 mijë vëzhgues në monitorimin e ditës së votimit më 11 qershor 2017.¹³ Pak ditë para zgjedhjeve, organizata “Instituti Rajonal për Demokraci të Drejtat e Njeriut dhe Studime Politike” kishte paraqitur kërkesë në KQZ për akreditimin e 4548 vëzhguesve për ditën e votimit më 11 qershor. Informacionet rreth kësaj OJQ-je ishin të mangëta dhe anëtarët e KQZ-së, kanë ngritur dyshimet e tyre në lidhje me qëllimin e kësaj organizate. Në mbledhjen e KQZ-së, të mbajtur më 9 qershor, dy ditë para ditës së votimit, anëtarët e KQZ-së kanë thënë se kjo OJQ është fantome, nuk ka as ueb faqe, dhe kanë

¹¹ Policia, Prokuroria dhe KQZ-ja të gatshme për zgjedhjet e 11 qershorit. Koha.net. 24 maj 2017. (Shih linkun <http://www.koha.net/arberi/20626/policia-prokuroria-dhe-kqz-ja-te-gatshme-per-zgjedhjet-e-11-qershorit/>)

¹² Vëzhguesit e BE-së: Zgjedhje vërtet konkurruese, por me disa dobësi të vjetra. Ekonomiaonline. 13 qershor 2017. (Shih linkun <http://www.ekonomiaonline.com/politike/vezhguesit-e-be-se-zgjedhje-vertet-konkurruese-por-me-disa-dobesi-te-vjetra/>)

¹³ “30 mijë vëzhgues këqyrin zgjedhjet e 11 qershorit”. 10 qershor 2017. Koha.net (Shih linkun <http://www.koha.net/zgjedhjet-lajme/24493/30-mije-vezhgues-keqyrin-zgjedhjet-e-11-qershorit/> dhe <http://www.kqz-ks.org/sq/lajme/Details/316>)

kundërshtuar akreditimin e vëzhguesve të saj.¹⁴ Por, zyrtarët e KQZ-së kanë deklaruar se nuk kanë autoritet të kundërshtojnë akreditimin e tyre, pasi kjo OJQ, kishte paraqitur certifikatën e regjistrimit të organeve kompetente të Republikës së Kosovës.¹⁵ Sidoqoftë, anëtarët e KQZ-së sërish kanë insistuar se nën petkun e OJQ-ve mund të veprojnë partitë politike, të cilat mund ta keqpërdorin numrin e vëzhguesve në ditën e votimit, duke i mvëshur me petkun e vëzhguesve të pavarur të shoqërisë civile.¹⁶ Ndaj këtij akreditimi të numrit të vëzhguesve të kësaj organizate janë ngritur dyshime të shumta dhe debat publik për aktivitetin dhe qëllimin e saj. Kjo kishte nxitur edhe median të hulumtoj për themeluesit e kësaj organizate, të cilët, rezultonin se kishin afërsi me lider të subjekteve politike.¹⁷ Dyshimet për përfshirje të militantëve të partive politike nën petkun e kësaj OJQ-je kishin shtyrë Prokurorinë Themelore në Gjakovë, që në ditën e votimit, të intervistonin 10 vëzhgues të saj, për t'i verifikuar. Pas verifikimit këta 10 vëzhgues ishin liruar të vazhdonin punën e tyre.¹⁸ KQZ përveç akreditimit të rreth 5000 vëzhguesve të kësaj OJQ-je nuk ka ndërmarrë asnjë hap drejtë zbardhjes së dyshimeve, duke hedhur gjithë përgjegjësinë tek Prokurori i Shtetit.¹⁹ Kjo e fundit, ka heshtur në lidhje me veprimtarinë e kësaj OJQ-je dhe qëllimin e saj në monitorimin e zgjedhjeve. Përderisa, partia VV ka paraqitur një kallëzim penal kundër kësaj OJQ-je në Prokurorinë Themelore në Prishtinë. Nuk ka përgjigje se çfarë është ndërmarrë në lidhje me parashtrimin e këtij kallëzimi penal.

c) Monitorimi i organeve të drejtësisë në ditën e votimit nga IKD, INPO dhe GLPS

Organizatat Jo-Qeveritare, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Iniciativa për Progres (INPO) dhe Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) me përkrahje të Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kanë monitoruar aktivitetet e institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë për mbrojtjen e votës në zgjedhjet e parakohshme nacionale, të mbajtura më 11 qershor 2017. Në ditën e votimit, IKD, GLPS dhe INPO kanë angazhuar 65 monitorues mobil, në 38 komunat e Republikës së Kosovës, për të raportuar lidhur me mbarëvajtjen e procesit zgjedhor dhe performancën e institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë për të gjitha rastet kur është shkelur e drejta e votimit, respektivisht kur ka pasur dyshime për kryerjen e veprave penale kundër të drejtës së votimit. Të gjithë 65 monitoruesit mobil, që nga hapja e vendvotimeve deri në përfundim të procesit të votimit kanë qenë në lëvizje të vazhdueshme duke vizituar dhe monitoruar pothuajse të gjitha qendrat e votimit në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

¹⁴ OJQ fantome që kërkoi akreditimin e mbi 4000 personave, habitë edhe KQZ' në. Peroskopi. 9 Qershor 2017. (Shih linkun <http://periskopi.com/ojq-fantome-qe-kerkoi-akreditimin-e-mbi-4000-personave-habite-edhe-kqz/>)

¹⁵ OJQ fantome që kërkoi akreditimin e mbi 4000 personave, habitë edhe KQZ' në. Peroskopi. 9 Qershor 2017. (Shih linkun <http://periskopi.com/ojq-fantome-qe-kerkoi-akreditimin-e-mbi-4000-personave-habite-edhe-kqz/>)

¹⁶ OJQ fantome që kërkoi akreditimin e mbi 4000 personave, habitë edhe KQZ' në. Peroskopi. 9 Qershor 2017. (Shih linkun <http://periskopi.com/ojq-fantome-qe-kerkoi-akreditimin-e-mbi-4000-personave-habite-edhe-kqz/>)

¹⁷ Zbulohet personi që e regjistroi në KQZ institutin e dyshimtë (Dokument). Periskopi. 10 qershor 2017. (Shih linkun <http://periskopi.com/zbulohet-personi-qe-e-regjistroi-ne-kqz-institutin-e-dyshimte-dokument/>)

¹⁸ Policia Shoqëron 10 Vëzhgues të OJQ-së Joaktive. Indeksonline.net. 11 qershor 2017. (Shih linkun <http://m.indeksonline.net/lajmet/policia-shoqeron-10-vezhgues-te-ojq-se-joaktive-97750/>)

¹⁹ Valdete Daka: Pyeteni prokurorinë për OJQ-në e vëzhguesve politikë. Gazetaobserver. 19 qershor 2017. (Shih linkun <http://gazetaobserver.com/valdete-daka-pyeten-prokurorine-per-ojq-ne-e-vezhguesve-politike/>)

Sipas monitorimit dhe raportimeve të monitoruesve të IKD-së, INPO-s dhe GLPS-së, Policia e Kosovës në koordinim me Prokurorin e Shtetit ka intervenuar në dhjetëra raste kur ka pasur dyshime apo janë raportuar raste lidhur me shkeljen e rregullave të zgjedhjeve që ndërlidhen me veprat penale kundër të drejtave të votimit.

Zyra Qendrore e procesit të monitorimit të IKD-së, INPO-së dhe GLPS-së e vendosur në Prishtinë, dhe monitoruesit mobil gjatë tërë ditës së zgjedhjeve kanë mbajtur kontakte të vazhdueshme me përfaqësues të Policisë dhe Prokurorisë lidhur me raportimin dhe monitorimin e veprimeve të Policisë dhe Prokurorisë në rastet kur ka pasur dyshime se janë kryer vepra penale kundër të drejtës së votimit.

Monitoruesit e terrenit në kohë reale kanë dërguar informata në Zyrën Qendrore të procesit të monitorimit të IKD-së, INPO-s dhe GLPS-së, për çdo parregullsi që kanë evidentuar gjatë procesit zgjedhor duke përfshirë edhe rastet kur ka pasur dyshime për kryerjen të veprës penale kundër të drejtës së votimit.

Të gjeturat kryesore që ndërlidhen me dyshimet për kryerje të veprës penale, kundër të drejtës së votimit si rezultat i monitorimit kanë përfshirë:

1. Në vendvotimin 2306D/03D, në fshatin Jazhincë të Komunës së Shtërpcës, një person me inicialet S.S. me urdhër të prokurorit të shtetit është intervistuar në stacionin e Policisë së Kosovës në Shtërpcë, pasi është raportuar se ka bërë fotografimin e votës.
2. Në Qendrën e Votimit të fshatit Mihaliq të Komunës së Vushtrrisë janë shpërndarë fletëvotime të fotokopjuara dhe të plotësuara me kandidatë të caktuar të një subjekti politikë. Lidhur me këtë rast, pjesëtarët e Policisë së Kosovës, të cilët ishin përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të zgjedhjeve në shkollën e lartcekur, nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim. Megjithatë, pas dërgimit të informatës në Prokurorin e Shtetit, nga Zyra qendrore e procesit të monitorimit të IKD-së, INPO-së dhe GLPS-së, pas 30 minutash, Prokurori i Shtetit ka urdhëruar Policinë e Kosovës të dalë në vend të ngjarjes për t'i larguar fletëvotimet e fotokopjuara. Në vendngjarje ka dal edhe prokurori kujdestar i shoqëruar nga policë hetues. Polici hetues i ngarkuar për këtë rast, ka intervistuar menaxherin e Qendrës së Votimit në këtë fshat, dhe fletëvotimet e fotokopjuara janë konfiskuar nga Policia e Kosovës. Gjithashtu, punëtori teknik i shkollës, i cili ka gjetur fletëvotimet, është shoqëruar në polici për të dhënë deklaratë, pasi i njëjti nuk kishte autorizim të qëndronte brenda hapësirave zyrtare të Qendrës së votimit.
3. Në fshatin Koshare të Ferizajt, në shkollën “Dëshmorët e Koshares”, policia ka shoqëruar për intervistim një person, i cili ka shpërndarë materiale propaganduese të një partie politike.
4. Faik Kajtazi, një nga zyrtarët policor të angazhuar në Qendrën e votimit në shkollën “Enver Hadri” në Smrekovicë të Komunës së Vushtrrisë, është familjar i kandidatit për deputet nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kurtan Kajtazi. Afërsinë familjare në mes tyre e konfirmoi edhe menaxheri i Qendrës së votimit në fjalë, Nehat Abazi, sipas të cilit Faik Kajtazi është xhaxhai i kandidatit të lartpërmendur. Megjithatë,

sipas Abazit, zyrtari policor në fjalë nuk ka ndikuar në asnjë votues. Ndryshe, edhe kandidati i PDK-së nga dega e Vushtrrisë, është po nga fshati Smrekovnicë, në të cilin xhaxhai i tij po kujdeset për mbarëvajtjen e zgjedhjeve. Pas publikimit të këtij informacioni, menaxheri i Qendrës së votimit në fjalë, Nehat Abazi dhe një komisioner e lajmërojnë policin Kajtazi. Ky i fundit e merr monitoruesin, e dërgon në një klasë dhe mohon se ka ndikuar te votuesit lidhur me procesin e votimit. Pas raportimit të këtij rasti në portalin Betimi për Drejtësi,²⁰ polici Faik Kajtazi e ka marrë në pyetje monitoruesin e IKD-së, të cilin e ka futur në një klasë, duke i kërkuar llogari se pse ka raportuar.

5. Në shkollën fillore “Asdreni” në Pejë, një person ka hyrë për të votuar duke pasur me vete katër me fletëvotime. Personi në fjalë është arrestuar nga Policia e Kosovës dhe me pas është ndaluar me urdhër të prokurorit.
6. Policia e Kosovës në objektin e shkollës fillore “Anton Zako Çajupi”, e ka lejuar të hyjë për të votuar personin i cili kishte të veshur maicë me mbishkrime të një subjekti të caktuar politik. Megjithatë, i njëjti nuk është lejuar të votojë nga drejtoresha e shkollës në fjalë.

Ndërsa, sa i përket mbarëvajtjes së përgjithshme të procesit zgjedhor IKD, INPO dhe GLPS kanë vlerësuar se procesi zgjedhor me 11 qershor 2017, ka kaluar në mënyrë të qetë, duke siguruar ambient të sigurt për qytetarët e Kosovës të cilët kanë dalë për të ushtruar të drejtën e tyre kushtetuese për të votuar. Gjatë procesit të monitorimit në ditën e votimit janë identifikuar kryesisht këto parregullsi apo pengesa:

- raste të raportuara të problemeve me logot e vulave zyrtare të KQZ-së në disa komuna;
- prezencë e personave të vdekur në lista të votimit,
- votimi me asistencë;
- votimi familjar;
- mungesë e emrit në listë të votimit;
- në raste të caktuara, prezenca e grupeve të caktuara pranë qendrave të votimit;
- në raste të caktuara ka pasur prani të personave të paautorizuar brenda Qendrave të votimit,
- raste të votimit më dokumente të UNMIK-ut dhe dokumente të Serbisë,
- mungesë të kartelave identifikuese për komisioner por të cilat më vonë janë siguruar nga KQZ-ja.
- në Leshak të Leposaviqit dhe në shkollën fillore “Dardania” në Prishtinë, është raportuar se kutia e votimit me kusht është mbushur plotë dhe nuk ka më vend për të proceduar me votime të tjera.

²⁰ Merret në pyetje monitoruesi që raportoi për afërsinë familjare mes policit dhe kandidatit të PDK-së për deputet. Betimi për Drejtësi. 11 qershor 2017. (Shih linkun <http://betimiperdrejtesi.com/merret-ne-pyetje-monitoruesi-qe-raportoi-per-afersine-familjare-mes-policit-dhe-kandidatit-te-pdk-se-per-deputet/>)

- në shkollën “Xhevat Jusufi” në fshatin Bare të Shalës së Bajgores deri në ora 13:30 nuk ka prezantuar asnjë zyrtar policor në Qendrën e votimit.
- gjithashtu, në Qendrën e votimit në Fakultetin Juridik në Prishtinë, në vendvotimin 1913E, një person ka tentuar të votojë dy herë, mirëpo nuk është lejuar nga anëtarët e vendvotimit. Lidhur me këtë rast, anëtarët e këshillit të vendvotimit nuk kanë raportuar tek Policia e Kosovës.

b. Rastet e iniciuara dhe hetimet penale rreth zgjedhjeve

Në kuadër të organizimit të zgjedhjeve nacionale të 11 qershorit 2017, në të gjitha Prokuroritë Themelore janë iniciuar raste ndaj 16 personave që dyshohen se kanë kryer vepra penale kundër të drejtës së votimit. Zbatimi i PSV-ve ka rritur efikasitetin dhe efektivitetin e veprimeve të policisë dhe prokurorëve në të gjitha rastet që ndërlidhen me veprat penale kundër të drejtave të votimit, duke bërë institucionet e sigurisë dhe ndjekjes më proaktive. Për dallim nga e kaluara, ku prej zgjedhjeve 2010 e tutje ka pasur me mijëra raste të iniciuara, prej krijimit të bashkëpunimit ndër institucional dhe zbatimit të PSV-ve ndërmjet PSH-së dhe PK-së numri i personave të përfshirë në incidente të zgjedhjeve ka rënë në shifra minimale. Në tabelën më poshtë janë paraqitur Prokuroritë Themelore, në të cilat janë parashtuar kallëzimet penale, numri i personave dhe veprat penale për të cilat pretendohet se janë kryer nga këta persona.

Ngritja e kallëzimeve penale dhe veprat penale për zgjedhjet e 11 qershorit 2017			
Prokuroria	Persona	Vepra penale	Neni
PTH Pejë	1	Kanosje e kandidatit	211
PTH Prishtinë	1	Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve	213
PTH Prizren	1	Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve	213
PTH Pejë	1	Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve	213
PTH Prishtinë	1	Keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve	214
PTH Pejë	1	Keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve	214
PTH Ferizaj	1	Keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve	214
PTH Pejë	1	Dhënia ose marrja e rryshfetit lidhur me votimin	215
PTH Prizren	1	Dhënia ose marrja e rryshfetit lidhur me votimin	215
PTH Pejë	1	Keqpërdorimi i të drejtës së votimit	216
PTH Ferizaj	1	Keqpërdorimi i të drejtës së votimit	216
PTH Ferizaj	1	Keqpërdorimi i të drejtës së votimit	216
PTH Pejë	1	Falsifikimi i rezultateve të votimit	219
PTH Prishtinë	1	Asgjësimi i dokumenteve të votimit	220
PTH Prishtinë	1	Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar; Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë	283; 437
PTH Gjilan	1	Lajmërimi apo kallëzimi i rremë	390
5	16	10	10

Tabela 1 - Burimi: Koordinatorja Nacionale për Zgjedhje në Prokurori të Shtetit dhe uebfaqja e PSh-së, gusht 2017

Sipas të dhënave zyrtare të Koordinatorës Nacionale për Zgjedhje në PSh dhe ueb faqes së PSh-së, rezulton se janë ngritur kallëzime penale ndaj 16 personave, prej të cilëve ndaj një personi për kryerjen e veprës penale “Kanosje e kandidatit” nga neni 211, ndaj tre personave për veprën

penale “Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve” nga neni 213, ndaj tre personave për veprën penale “Keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve” nga neni 214, ndaj dy personave për veprën penale “Dhënia ose marrja e ryshfetit lidhur me votimin” nga neni 215, ndaj tre personave për veprën penale “Keqpërdorimi i të drejtës të votimit” nga neni 216, ndaj një personi për veprën penale “Falsifikimi i rezultateve të votimit” nga neni 219, ndaj një personi për veprën penale “Asgjësimi i dokumenteve të votimit” nga neni 220, ndaj një personi për dy vepra penale “Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar” nga neni 283 dhe “Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë” nga neni 437, si dhe ndaj një personi për veprën penale “Lajmërimi apo kallëzimi i rremë” nga neni 390 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Të gjitha kallëzimet penale ndaj këtyre personave janë ushtruar në PTh-të të Prishtinës, Prizren, Pejë, Ferizaj dhe Gjilan.

Përderisa, KQZ ende nuk ka dërguar asnjë rast tek Prokurori i Shtetit²¹, PZAP bazuar në rastet e pranuar dhe shqyrtuara, ka dërguar 14 dosje në Prokurori të Shtetit, për të cilat ka konsideruar se mund të ketë elemente të veprave penale për t’i hetuar më tutje. Përveç këtyre 14 rasteve, për zgjedhjet e 11 qershorit 2017, PZAP ka trajtuar 421 ankesa të ndryshme që ndërlidhen me këtë proces zgjedhor. Prej tyre 21 ankesa i takojnë kohës së para fushatës zgjedhore, 177 ankesa gjatë fushatës zgjedhore, 88 ankesa për thyerje të heshtjes zgjedhore, 67 ankesa për ditën e votimit, 2 ankesa për rezultatet preliminare dhe 66 ankesa për rezultatet përfundimtare. Në lidhje me këto raste, PZAK ka vendosur që 179 ankesa t’i miratoj si të bazuara, 150 ankesa t’i refuzoj, 33 ankesa i ka hudhur si të palejuara, 37 ankesa janë hudhur si të pasaftshme, 4 ankesa janë hudhur si të parregullta, në 16 ankesa palët janë tërhequr, 1 çështje është gjykuar, ndërsa 1 ankesë është dërguar në KPMK.

Për të gjitha ankesat, PZAP ka shqiptuar gjopa ndaj subjekteve politike për shkak të shkeljes së kodit të mirësjelljes së Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme gjatë fushatës zgjedhore në shumën prej 348.900.00 euro.

²¹ Komunikim përmes postës elektronike me zyrtarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, z. Xhemail Peçani. “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për çdo palë zgjedhje ka ngritur Kallëzime Penale për të dyshuarit, të cilët ditën e votimit, kanë shfrytëzuar të drejtën për të votuar, si votues të rregullt. Edhe përkundër asaj që kanë votuar si votues të rregullt, në kundërshtim me nenin 91 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, dyshohet se kanë votuar edhe si votues me kusht andaj, ekziston dyshimi i bazuar se kanë kryer vepër penale, keqpërdorim i të drejtës së votimit, e sanksionuar me nenin 216 paragrafi 1.2 të Kodit Penal të Republikës të Kosovës. Për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës të 11 qershorit 2017, KQZ ende nuk i ka dërguar rastet e personave në Prokurorin e Shtetit lidhur me dyshimet për kryerjen e veprave penale kundër të drejtës së votimit? Në momentin që këto raste t’i dërgojmë në PSh do ju njoftojmë në kohen sa ma të shpejtë të mundshme”. Korrik 2017.

c. Ngritja e aktakuzave dhe shpallja e aktgjykimeve

Lëndët e zgjedhjeve të viteve paraprake, vazhdojnë të sfidojnë ende seriozisht prokurorët dhe gjykatësit, të cilët ende kanë të pazgjidhura lëndët e zgjedhjeve nacionale të vitit 2010, zgjedhjeve lokale të vitit 2013, zgjedhjeve nacionale të vitit 2014, zgjedhjeve lokale për Kryetar të Komunës së Drenasit të vitit 2016.²² Sidoqoftë, për zgjedhjet e 11 qershorit 2017, nga kallëzimet penale që janë ngritur ndaj 16 personave, prokurorët kanë ngritur aktakuza ndaj 7 personave. Prej tyre ndaj tre personave janë shpallur aktgjykime dënuese, si rezultat i pranimit të fajësisë nga të akuzuarit, ndërsa rastet tjera janë në proces. Për më tepër shih më poshtë tabelën e këtyre rasteve dhe përshkrimin e secilës aktakuzë të ngritur nga Prokuroritë Themelore.

Aktakuzat dhe aktgjykimet për zgjedhjet e 11 qershorit 2017					
Prokuroria	Të akuzuar	Ngritja e aktakuzës	Aktgjykim		Proces
			Lirues	Dënues	
PTh Pejë	1	12.06.2017			1
PTh Pejë	1	12.06.2017		1	
PTh Pejë	1	16.06.2017		1	
PTh Pejë	1	05.07.2017			1
PTh Prizren	1	01.08.2017			1
PTh Pejë	1	19.07.2017			1
PTh Prishtinë	1	12.06.2017		1	
3	7		0	3	4

Tabela 2 – Aktakuzat dhe aktgjykimet për zgjedhjet e 11 qershorit 2017

1) Aktakuzë për dhënie ose marrje e ryshfetit në lidhje me votimin

PTh në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, më 1 gusht 2017 ka ngritur aktakuzën kundër të dyshuarve F.K. dhe F.B. Sipas aktakuzës, i pandehuri F.K., i ka premtuar përfitim të pamërituar personit tjetër me qëllim që ta ndikojë atë person për të votuar në favor të një personi. Një ditë para ditës së votimit më 10 qershor 2017, në një lokal në Prizren, personin F.B. e bind që të dalë në vendvotim dhe të votojë për kandidatin për deputet B.K., duke premtuar se për këtë shërbim do të ia paguaj 15 euro dhe duke i ofruar kartelën e kandidatit të lartpërmendur për deputet me dy numra, njëri numër i subjektit politik dhe tjetri i vetë kandidatit, pastaj edhe lapsin kimik me video-kamerë me ngjyrë të zezë për ta incizuar – fotografuar aktin e votimit për kandidatin gjegjës. Me këto veprime, i pandehuri F.K. ka kryer veprën penale “dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin nga neni 215 paragrafi 1, i Kodit Penat të Republikës së Kosovës.”

²² *Shënim:* Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës ende nuk kanë një bazë të dhënave të harmonizuara përmes të cilave do të mundësohej një analizë e mirëfilltë e trajtimit të rasteve të zgjedhjeve të mbajtura në vitet paraprake. IKD vazhdimisht ka adresuar kërkesa në KGJK, KPK dhe tek Koordinatorja Nacionale për Zgjedhje në Prokurori të Shtetit, por asnjëherë nuk ka arritur të sigurojë të dhëna të besueshme, të cilat korespondojnë mes vete. Prandaj, në këtë raport, nuk do ju referohemi fare të dhënave të rasteve të zgjedhjeve paraprake për shkak të diskrepancës së madhe që kanë statistikave të KPK-së, KGJK-së dhe Koordinatorës Nacionale për Zgjedhje në Prokurori të Shtetit.

I pandehuri F.B., ka pranuar ofertën apo premtimin për përfitim të pamërituar për vete, për të votuar në favor të një personi, në atë mënyrë që në ditën e votimit, më 11 qershor 2017, shkon në vend votimin përkatës të Qendrës së Votimit, të vendosur në shkollën e mesme teknike “11 Marsi” në Prizren dhe me lapsin kimik me video kamerë, me ngjyrë të zezë, kryen aktin e votimit për kandidatin e lartpërmendur për deputet, me ç’rast zbulohet nga vëzhguesi i vendvotimit përkatës. Me këto veprime, i pandehuri F.B. ka kryer veprën penale “dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin nga neni 215 paragrafi 2, i Kodit Penat të Republikës së Kosovës.”

2) Aktakuzë për veprë penale “Keqpërdorim i të drejtës së votimit”

PTH në Pejë, Departamenti i Krimeve të Rënda, më 19 korrik 2017 ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve N.L. dhe N.L. për veprë penale “Keqpërdorimi i të drejtës së votimit” nga neni 216 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Sipas aktakuzës, të pandehurit N.L. dhe N.L. me datë 11.06.2017 rreth orës 10:00 në fshati Dranoc Komuna e Deçanit, me dashje, duke vepruar si bashkëkryerës, votojnë për të dytën herë edhe pse e kanë ditur se kanë votuar njëherë, ashtu që të pandehurit fillimisht kanë shkuar me dëshmitarin S.H. në qendrën e votimit në vendin e lartcekur dhe kanë votuar, pasi kthehen në shtëpi prapë shkojnë me dëshmitarin Sh.L. dhe përsëri votojnë në të njëjtën qendër të votimit. Të pandehurit N.L. dhe N.L. me veprimet e tyre kanë përmbushur elementet e veprave penale të përshkruara sikur më lart. Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që të pandehurit t’i shpall fajtor dhe t’i dënoj sipas ligjit për veprën penale e cila i vihet në barë.

3) Aktakuzë për veprë penale “Dhënia ose marrja e ryshfetit lidhur me votën”

PTH në Pejë, Departamenti i Krimeve të Rënda, më 5 korrik 2017, në Gjykatën Themelore në Pejë, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit A.S. për veprë penale “Dhënia ose marrja e ryshfetit lidhur me votën” nga neni 215 paragrafi 1 të KPRK-së. Sipas aktakuzës, i pandehuri A.S. me dt. 26.05.2017 rreth orës 15:26 minuta në fshatin Vitomeric Komuna Pejë, ka premtuar dhurata personit tjetër me të drejtë vote me qëllim që të votoj partinë NDS e cila udhëhiqet nga i pandehuri, ashtu që, i njëjti përmes rrjetit social facebook kishte dërguar mesazh personit D.S. dhe kishte kërkuar që të votohet kjo parti në këmbim me 50€ dhe do të sigurohen edhe shpenzimet e rrugës. I pandehuri me këto veprime duke premtuar dhënien e përfitimit prej 50 eurove në këmbim të votës së votuesve ka përmbushur elementet e veprës të përshkruar sikur më lart. Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtoj dhe ta dënoj sipas ligjit për veprën penale e cila vihet në barë.

4) *Aktakuzë për veprë penale “Keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve”*

PTh në Pejë, Departamenti i Krimeve të Rënda, më 16 qershor 2017 ka ngritur aktakuzën me marrëveshje mbi pranimin e fajësisë kundër të pandehurit L.A. për veprë penale “Keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve” nga neni 214 i Kodit Penat të Republikës së Kosovës. Sipas aktakuzës, i pandehuri L.A. më 11 qershor 2017 në shkollën fillore “Asdreni” në Pejë, si person zyrtar dhe atë si koordinator i vëzhguesve të njërit nga subjektet politike pjesëmarrëse në zgjedhje, duke keqpërdor pozitën apo autoritetin e tij, këshillon votuesit që të votojnë në favor të subjektit politik që ai përfaqësonte, ashtu që i pandehuri fillimisht i jap dëshmitarit N.M. një kopje të fletëvotimit se cilët kandidatë dhe subjekt politik të votojë, ndërsa më pas i njëjti ndalohet nga Policia e Kosovës të cilët në çantën e të pandehurit gjejnë dhe sekuestrojnë gjashtë kopje të pa plotësuar të fletëvotimeve. I pandehuri me këto veprime duke keqpërdor pozitën, detyrën dhe autoritetin e tij, si person zyrtar ka përmbushur elementet e veprës të përshkruar sikur më lart. **Prokurori i çështjes ka ngritur aktakuzë me marrëveshje për pranimin e fajësisë në Gjykatën Themelore në Pejë, e cila ka shqiptuar aktgjykim dënues.**

5) *Aktakuzë për asgjësim të dokumenteve të votimit*

Prokuroria Themelore në Prishtinë më 13 qershor 2017 ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit D.P. për veprë penale “Asgjësimi i dokumenteve të votimit nga neni 220 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, e që lidhet me procesin zgjedhor të 11 qershorit 2017. Sipas aktakuzës, i pandehuri D.P., në qendrën e votimit në fshatin Dobratin të Graçanicës, nën ndikim të alkoolit i revoltuar me arsye se kinse djali i tij nuk po lejohet të votojë në mungesë të dokumenteve identifikuese të Kosovës, ka ofenduar anëtarët e komisionit zgjedhor dhe fletëvotimin e vet e ka dëmtuar duke e shqyer. **Pas veprimeve hetimore dhe ngritjes së aktakuzës, sot është mbajtur seanca gjyqësore e shqyrtimi fillestar, ku i akuzuari e ka pranuar fajësinë dhe nga Gjykata kompetente është shpallur fajtor për veprën e kryer.**

6) *Aktakuzë për cenimin e përcaktimit të lirë të votuesve*

Prokuroria Themelore në Pejë ka ngritur aktakuzë ndaj një personi për kryerjen e veprës penale “Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve”, nga neni 213, në komunën e Gorazhdecit. **Aktakuza është ngritur më 12 qershor 2017, ndërsa Gjykata Themelore në Pejë të njëjtën ditë e ka dënuar, pasi i akuzuari e ka pranuar fajësinë.**

7) *Aktakuzë për kanosje të kandidatit*

Prokuroria Themelore në Pejë ka ngritur aktakuzë ndaj një personi për kryerjen e veprës penale “Kanosje e kandidatit” nga neni 211 në komunën e Pejës. Aktakuza është ngritur më 12 qershor 2017.

6. Rekomandimet

IKD ka nxjerrë rekomandimet në vazhdim, të cilat do të kontribuonin avancimin e ndjekjes dhe gjyqimit të rasteve që ndërlidhen me veprat penale kundër të drejtave të votimit:

Institucionet që janë nënshkrues të Memorandumit të Bashkëpunimit lidhur me zgjedhjet e vitit 2017, duhet sa më parë të shkëmbejnë përvojat dhe mësimet e nxjerra nga këto zgjedhje ashtu që të identifikojnë mangësitë dhe praktikat e mira dhe të adresojnë menjëherë këto çështje. Temat me interes për këtë pjesë do të ishin:

- Avancimi i akteve normative sa i përket rregullimit të procedurave dhe përcaktimit të detajuar të përgjegjësisë të zyrtarëve të ndryshëm në procesin zgjedhor
- Informimi i publikut lidhur me vendin e votimit për votues, në mënyrë që informohen me kohë rreth ndërrimit të adresës së vendvotimit.
- Avancimi i mënyrave të komunikimit ndërinstytucional
- Sensibilizimi i opinionit rreth mundësive të bashkëpunimit me organet e drejtësisë si dhe edukimi i tyre rreth rreziqeve dhe pasojave juridike në rast të përfshirjes në kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit. Ndër tjera, këto diskutime duhet të shtjellojnë edhe çështjen e ngritjes së besimit të qytetarëve në institucione të drejtësisë dhe lajmërimit të rasteve në kanale zyrtare, ku edhe do marrin përgjigje nga organet përkatëse.
- PSh dhe PK duhet të avancojnë PSV-të duke u bazuar në praktikat dhe mësimet e nxjerra gjatë zbatimit të PSV-ve gjatë këtij procesi të zgjedhjeve. Gjatë hartimit të PSV-ve, duhet kushtuar kujdes respektimit të kornizës ligjore për të mbrojtur liritë dhe të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe konventat ndërkombëtare.
- PSh dhe PK duhet të zhvillojnë hetime të detajuara siç obligohen me legjislacionin pozitiv dhe PSV në drejtim të sigurimit të elementeve të krimit të organizuar, duke ndjekur organizatorët e kryesve të krimeve të zgjedhjeve.
- PSh duhet të hetoj dyshimet të cilat janë ngritur dhe mund të ngritën rreth mënyrës së financimit të partive politike dhe shpenzimeve të këtyre partive politike, posaçërisht pas procesit të auditimit të financave të partive politike
- Gjykatësit sugjerohen të kuptojnë shkallën e rrezikshmërisë, rëndësinë e zgjedhjeve dhe veprave penale kundër të drejtave të votimit dhe të shqiptojnë masa adekuate ndaj të pandehurve.